

URDHËR
Nr. 615, datë 9.11.2020

PËR KUFIZIMIN E AKTIVITETEVE TË BAREVE, RESTORANTEVE, *FAST FOOD*
DHE LOKALEVE

(ndryshuar me urdhrin nr. 659, datë 2.12.2020, nr. 680, datë 21.12.2020)

Në zbatim të nenit 7, pika 4, germa “b”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, si dhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga *Coronavirus* i ri nr. 5005, datë 9.11.2020, me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

1. *Kufizimin e aktivitetit të bareve, restoranteve, fast food, lokaleve që ofrojnë shërbim për klientët në të gjithë vendin, nga ora 20:30 deri në orën 06:00 duke filluar nga datë 24.12.2020 deri në datën 4.1.2021.*

2. Përfundim nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 bëhet vetëm për shërbimin në banesë (*delivery*), i cili duhet të kryhet duke respektuar rregullat higjienike të miratuara.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri organet kompetente për dhënien e masave administrative, sipas aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i fillon efektet më datë 11.11.2020.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu